



Datë: 04.12.2025
Numër Protokolli: 7723/2025

A.nr.1831/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1831/2025 të datës 22.10.2025, të parashtruar nga ankuesi V.G, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1831/2025, e datës 22.10.2025, e parashtruar nga ankuesi V.G.

II. **Anulohet** Njoftimi me numër protokolli 1405/2025 i datës 06.10.2025, lidhur me rezultatin përfundimtar, sipas Konkursit, me numër reference RN00018337, si dhe lista me numër 1279/2025 e datës 12.09.2025 për verifikimin paraprak për grupin i prokurimit publik për pozitën “*Ekspert Shqyrtues*” ndërsa çështja kthehet në fazën e verifikimit paraprak.

III. **Obligohet** Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, të ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimi në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi,

IV. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, V.G(në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), me datë 22.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit respektivisht konkursit me numër reference RN00018337 të datës 30.07.2025 , të Organit Shqyrtues së Prokurimit për pozitën e punës “*Ekspert Shqyrtues*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 23.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Organi shqyrtues i Prokurimit, ndërsa kjo e fundit, me datë 05.11.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6932/2024 e parashtruar nga ankuesi më datën 22.10.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër 1367/2025 të datës 30.09.2025; Njoftimin me numër 1279/2025 të datës 12.09.2025; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.10.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1831/2025 të datës 05.11.2025; Kërkesën për shpallen e procedurës së rekrutimit të datës 30.07.2025; Vendimin me numër 1292/2025 të datës 16.09.2025 për themelimin e komisionit të rekrutimit; Njoftimin me numër 1504/2025 të datës 06.10.2025; Listën e aplikantëve ; Emalin e datës 30.09.2025; Emalin e datës 06.10.2025; Konkursin me numër reference RN00018337 të datës 30.07.2025; Njoftimin me numër 1279/2025 të datës 12.09.2025; Formularët e vlerësimit të datës 22.09.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 06.10.2025; Përshkrimin e detyrave të punës lidhur me pozitën rekrutuese; Akt emërimit me numër 1300/2025 të anëtarit të komisionit I.H; Akt emërimit me numër 1214/2025 të anëtarit të komisionit V.B; Akt emërimit me numër 1215/2025 të anëtarit të komisionit S.B; Akt emërimit me numër 1219/2025 të anëtarit të komisionit A.B; Akt emërimit me numër 137/2020 të anëtarit të komisionit B.H; Formularin e shpenzimeve të departamentit, divizionit, sektorit të OSHP-së; Formularët e vlerësimit të datës 06.10.2025 nga ana e komisionit për kandidaten V.I; Aplikacionin e kandidatës së përzgjedhur V.I së bashku me përgatitjen profesionale, përvojën e punës dhe shkresat tjera me rastin e aplikimit; Formularët e Vlerësimit të datës 06.10.2025 nga ana e komisionit të vlerësimit për kandidatin e përzgjedhur G.D; Aplikacionin e kandidatit të përzgjedhur G.D së bashku me përgatitjen profesionale, përvojën e punës dhe shkresat e tjera me rastin e aplikimit; Aplikacionin e ankuesit V.G përgatitjen profesionale përvojën e punës dhe dokumentacionin lidhur me rastin e aplikimit;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Organi Shqyrtues i Prokurimit më datë 30.07.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00018337, për pozitën “*Ekspert Shqyrtues*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 31.07.2025 deri më 29.08.2025.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar shtatëdhjetë e gjashtë (76) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, dhe sipas njoftimit të datës 12.09.2025 për verifikim paraprak janë përfshirë katërdhjetë e tetë (48) kandidat që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesi.

Pas përfundimit të fazës së testit me shkrim me datë 30.09.2025 ankuesi përmes emailit zyrtar është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në OSHP se nuk ka kaluar testin me shkrim pasi që i njëjti ka arritë tridhjetë e tri pikë katër (33.4) pike, dhe se nuk mund të vazhdojë procedurën e rekrutimit tutje. Tutje me datë 06.10.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në OSHP, ka publikuar njoftimin me numër 1405/2025 lidhur me përfundimin e rezultateve përfundimtare për pozitën e punës “Ekspert Shqyrtues” dy pozita ku nga kjo listë rezultojnë si kandidatë fitues kandidatja V.I e cila ka arritë 63.2 pikë në testin me shkrim dhe 26 pikë në interviste me gjithsej 89.2 pikë, si dhe kandidati G.D ka arritë 53.4 pikë në testin me shkrim dhe 25.2 pike në interviste me gjithsej 78.6 pike.

Ankuesi në ankesën me numër protokolli 6932/2025 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kandidatet fitues në këtë procedure të rekrutimit nuk e kanë përvojën e punës ashtu siç është kërkuar në konkurs, testi me shkrim ka pasur parregullsi, në këtë procedure ka pasur diskriminim dhe konflikt interesi dhe është përcjell me mungesë transparence dhe favorizime, duke kërkuar nga këshilli ti aprovojë ankesën e ankuesit dhe ta anuloj procedurën e rekrutimit për pozitën e punës “Ekspert Shqyrtues”.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit për pozitën “Ekspert Shqyrtues” numër i të punësuarve dy në Organin Shqyrtues të Prokurimit, dhe si rrjedhojë nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00018337, ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Fakulteti Ekonomi, Juridik ose Administratë Publike. **Kërkesat specifike:** Certifikate, licenca kur kërkohet me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ndërsa, në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 par. 1, 2: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; **1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;** dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtarëve/publik, mund të kërkohen kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

Ne kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e në mbështetje të nenit 86 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kolegji ka analizuar, dosjen e kandidatëve fitues respektivisht kandidates, V.B e cila për nga përgatitja profesionale/ arsimi posedon Diplomën e datës 05.11.2021 të lëshuar nga kolegji Rinvest me të cilën mori titullin Bachelor i arteve në menaxhimin e biznesit, ndërsa lidhur me përvojën e punës ka ofruar si dëshmi marrëveshjen për angazhim për Punë-Praktike në Ministrinë e Financave prej datës 01.06.2023 deri me 19.09.2023, e cila a kryer punë tekniko- administrative, tutje me datë 20.12.2023 ka themeluar marrëdhënien e punës në OSHP për kohë të caktuar nga data 20.09.2023 deri me 20.09.2024 si nëpunës administrativ dhe mbështetës në të cilën pozite ka kryer punë administrative, duke u kujdesur për telefonatat, posten, ka menaxhuar kalendarin e takimeve dhe organizimeve të kryetarit të OSHP-se, ndërsa me datë 20.09.2024 deri me datë 20.12.2024 sipas kontratës për marrëdhënie me afat të caktuar ka mbajtur pozitën e punës Zyrtare ekzekutive në OSHP e cila ka kryer punë duke siguruar mbështetje administrative përfshirë posten zyrtare, telefonin ka përgatit dhe modifikua dokumentet duke përfshirë korrespondenca, raportet, memorandumet, agjendat, ka ruajtur dhe mirëmbajtur sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve të kryetarit të OSHP-së, si dhe me datë 29.01.2025 e njëjta ka themeluar marrëdhënien e punës sipas Akt emërimit me numër 93/25 në Organin Shqyrtues në OSH, në pozitën e punës “Zyrtare Ekzekutive” pa afat, andaj kolegji i këshillit pas analizimit të përvojës së punës ka konstatuar se kandidatja V.I ka gjithsej përvojë të punës 2 vite e 14 ditë në pozitën si “Asistente Ekzekutive” në të cilën pozitë ka kryer punë tekniko administrative e cila nuk përputhet me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Ekspert Shqyrtues” ashtu siç është kërkuar sipas konkursit të datës 30.07.2025 ku përvoja e punës është kërkuar në fushën për të cilën zhvillohet procedura. Ndërsa lidhur me dosjen e kandidatit G.D po ashtu kandidat fitues në këtë procedurë të rekrutimit i njëjti si dëshmi ka afuar përgatitjen profesionale / arsimi diplomën me numër 447 të lëshuar nga Fakulteti ekonomik “Kadri Zeka” me të cilën e mori titullin Bachelor në Menaxhment, ndërsa lidhur me përvojën e punës i njëjti ka ofruar si dëshmi marrëveshjen për shërbime të veçanta në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për periudhë kohore nga data 02.10.2019 deri 15.11.2019, kontratën e datës 01.09.2014 në kompaninë IPKO i cili ka kryer punë nga data 01.09.2014 deri 01.03.2015, mirë po këshilli nuk e merr për bazë këtë përvojë pune pasi që është para diplomimit, marrëveshjen e datës 12.02.2021 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me afat të caktuar nga data 12.02.2021 deri 31.03.2021 i cili ka kryer punë në qendrën e numërimit të rezultateve në zgjedhjet si kryesues i tavolinës, po ashtu përvojën e punës në IPKO nga viti 2020 në pozitën zyrtar i logjistikes, kolegji i këshillit ka konstatuar se kandidati fitues G.D nuk i plotëson krateret sa i përket përvojës së punës pasi që i njëjti nuk ka përvojës punës siç është kërkuar sipas konkursin në fushën e prokurimit.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi i ankuesit lidhur me përvojën e punës së kandidatëve të përzgjedhur është i bazuar, kështu që, mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe rrethanave, rrjedhë së Njësia e Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, me rastin e përfshirjes në listën e verifikimit paraprak të kandidatëve V.I dhe G.D këtu, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: *7.Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;* dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: “ *Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Kolegji i Këshillit po ashtu gjatë analizimit të konkursit me numër Reference RN00018337 të datës 30.07.2025 për Grupin e Prokurimit Publik për pozitën e punës “ *Ekspert Shqyrtues*” ka gjetur se në vendimin me numër 1292/2025 të datës 10.09.2025 për themelimin e komisionit për pranim dhe vlerësim profesional në përbërje kanë qenë V. Shala në cilësinë e kryetarit të komisionit i cili sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshëm*, A.B. në cilësinë e anëtares se komisionit e cila sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore*, S. B në cilësinë e anëtarit të komisionit i cili sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për shqyrtimin e Ankesave*, I. H në cilësinë e anëtarit të komisionit i cili sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës *Ekspert Shqyrtues*, si dhe B.H në cilësinë e anëtares e cila sipas akt emërimit mbanë pozitën e punës *Ekspert Shqyrtues*.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të drejte të ankesës së parashtruar nga ankuesi iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, gjegjësisht:

-Neni 40 Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale 1. Vlerësimi profesional i kandidatëve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësi përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale. 3. Komisioni i pranimit zgjidhet ad hoc për çdo grup të administrimit të përgjithshëm apo të veçantë nga lista e kandidatëve/ëve potencial. Lista e kandidatëve/ëve potencial për anëtarë/ë të komisionit miratohet nga Qeveria me propozim të ministres/it përgjegjës për administratë publike ndërsa për institucionin tjetër shtetëror nga titullarja/i i institucionit përkatës dhe ka vlefshmëri për dy (2) vite, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës. 4. Komisioni i pranimit përzgjidhet përmes sistemit kompjuterik në mënyrë algoritmike nga njësi përgjegjëse, e cila emëron komisionin e pranimit.

Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë: *Neni 20 Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale 1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidatëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale themelohet me vendim të Zyratit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse. 3. Për secilin nga kategoritë e anëtarëve të Komisionit, caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor. 4. Në procedurë rekrutimi për pozita të kategorisë profesionale në cilësinë e vëzhguesve mund të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe sindikatat.*

Tutje Kolegji ka konstatuar se pjesë e Komisionit të Pranimi nga kategoria e Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk ka qenë asnjë nga anëtarët sepse A.B në këtë rast nuk munde ta mbaje edhe pozitën e udhëheqëses edhe të zyrtarit të personelit dhe njëherit dy nga anëtarët e komisionit kanë pozitën ekuivalente me pozitën e cila është në proces të rekrutimit andaj institucioni respektivisht Organi Shqyrtues i Prokurimit në këtë rast nuk e ka respektuar Nenin 16 paragrafi 1, 2, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 1. *Çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik në fushën e veprimit të këtij ligji, duhet të ketë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive.* 2. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka këto kompetenca: 2.1. ofron mbështetje për nëpunësen/in më të lartë administrativ dhe/apo për titullaren/in e institucionit në fushën e burimeve njerëzore; 2.2. përgatit planin vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit; 2.3. ofron ndihmë për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës; 2.4. identifikon dhe vlerëson, në koordinim me udhëheqësen/in e njësisë në mënyrë periodike, nevojat për trajnim të nëpunësve/ëve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional; **2.5. menaxhon proceset e ndërlidhura me emërimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, transferimit, suspendimit, pensionimit dhe çdo proces tjetër që ndërlidhet me punësimin e zyrtareve/ëve publik;** 2.6. mbështet procedurën për vlerësimin e performancës, rekomandon transferimin e nëpunës/it civil, si dhe menaxhon paraqitjen në punë të zyrtares/it publik; 2.7. administron planet dhe dosjet individuale përmes SIMBNj-së; 2.8. kryen çdo detyrë tjetër të dhënë me ligj. Andaj vendimi me numër 1292/25 i datës 16.09.2025 i U.D Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-se është themeluar në kundërshtim me dispozitat si me lartë.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, dhe nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh që dy kandidatet e listës fituese nuk e kanë përvojën e punës ashtu siç është kërkuar sipas konkursit me numër reference RN00018337 i datës 30.07.2025 për pozitën e punës “Ekspert Shqyrtues” si dhe komisioni i pranimi nuk ka qenë i themeluar sipas kriterëve ligjore, atëherë edhe procedura e vlerësimit të kandidatëve, testit me shkrim, dhe intervistës me gojë si dhe verifikimi paraprak, është i pavlefshme, andaj duke marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në pretendimet tjera të ankuesit, e për rrjedhojë duke marr parasysh diapozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi obligohet Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-se, të ndërmarr veprimet për Themelimin e Komisionit të Pranimi në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim që procedura të zhvillohet nga faza verifikimit paraprak dhe pastaj e vlerësimit profesional.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.1831/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, V.G;
- Organit të punësimit: U.D Kryesuesit te Sekretariatit te OSHP-së dhe
- Njesisë se Burimeve Njerëzore ne OSHP
- Arkivit të KPMSHCK-së.